



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 19.05.2021

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik.

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “**SHPRESA – AL**” shpk me NUIS K31321021N dhe adresë: Rruga “Urani Pano”, mbrapa “Veve Center”, Pallati Nr.11, Kati 2, Tiranë.

* * *

Procedura e prokurimit: E hapur

Numri i referencës së procedurës: REF-90630-03-20-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje inerte”, me afat lëvrimi nga nënshkrimi i kontratës deri më datë 31.12.2021 sipas nevojave dhe kërkesave të Autoritetit Kontrator dhe me fond limit 44.565.083 (dyzet e katër milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr.45, datë 29.03.2021

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomike më e favorshme X çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “**B93 II**” shpk me NUIS L522090500 me ofertë ekonomike **34.607.000** (tridhjetë e katër milion e gjashtëqind e shtatë mijë) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “**BAMI**” shpk me NUIS J94416206R me ofertë ekonomike **41.762.000** (dyzetë e një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “**KRONOS KONSTRUKSION**” shpk me NUIS K41416033P me ofertë ekonomike **43.471.000** (dyzetë e tre milion e katërqind e shtatëdhjetë e një mijë) lekë pa tvsh.

4. Operatori ekonomik “**S I R E T A 2F**” shpk me NUIS K51501008J me ofertë ekonomike **35.555.555** (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.
5. Operatori ekonomik “**SHPRESA – AL**” shpk me NUIS K31321021N me ofertë ekonomike **39.983.000** (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mije) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. Operatori Ekonomik “**B93 II**” shpk me NUIS L522090500.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 1, shkronja e, të kritereve të veçanta të kualifikimit ku është parashikuar se *“Ofertuesi duhet të dorëzojë: e) Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë, që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”* pasi nuk ka paraqitur vërtetimin e kërkuar më sipër.
- Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesi fletë analizë ose raport testimi për mallrat objekt prokurimi, të lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të lëshuar nga një laborator i çertifikuar nga organet kompetente të Shtetit Shqiptar.”*
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur fletë analizë ose raport testimi për të gjithë mallrat objekt prokurimi pasi mungon fletë analiza ose raporti i testimit për zërin çimento, filer, rërë e larë dhe gurë kave. Ndërsa raportet e testimit e paraqitura për zërat e tjerë mbajnë datën 17.01.2020 në kundërshtim me përcaktimin e mësipërm ku kërkohet që raportet e testimit duhet të jenë lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hapjes së ofertave.
- Nuk përmbush pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesi analizën e çmimeve për të gjithë zërat objekt prokurimi.”* pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.3.11 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: *“Operatori ekonomik duhet të paraqesi dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.*

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 14 t</i>	<i>5 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion me kapacitet mbajtës 1.5 - 2 t</i>	<i>2 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Kamion me vinç</i>	<i>1 copë</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).*
- b) *Për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, i cili duhet të jetë deri në përfundim të objektit.*

- c) *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të dallohet qartë marka dhe targa e mjetit.*
- d) *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese)."*

- Kapaciteti mbajtës i mjetit me targë AA431LC është 1331 kg, kapacitet ky nën kapacitetin e kërkuar prej 1.5-2 ton.
- Kapaciteti mbajtës i mjetit me targë AA653TB është 1151 kg, kapacitet ky nën kapacitetin e kërkuar prej 1.5-2 ton.

Si rrjedhim operatori ekonomik nuk përmbush kriterin për të paraqitur kamion me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton.

2. Operatori Ekonomik **"BAMI"** shpk me NUIS J94416206R.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: "Operatori ekonomik duhet të paraqesi fletë analizë ose raport testimi për mallrat objekt prokurimi, të lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të lëshuar nga një laborator i çertifikuar nga organet kompetente të Shtetit Shqiptar." pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: "Operatori ekonomik duhet të ketë impiant prodhimi dhe përpunimi të inerteve në pronësi/me qera ose të paraqesë Kontratë Furnizimi për mallrat objekt prokurimi, të lidhur para noterit, me afat deri në përfundimin e kontratës. Për impiantin duhet të paraqitet Leje Mjedisore tipi B (Kodi III.1.B) në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme deri në realizimin e kontratës." pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: "Operatori ekonomik duhet të paraqesi analizën e çmimeve për të gjithë zërat objekt prokurimi." pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

3. Operatori Ekonomik **"KRONOS KONSTRUKSION"** shpk me NUIS K41416033P.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) shoferë të mjeteve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për muajin e fundit. Për shoferët lejohet të paraqitet edhe kontratë bashkëpunimi." pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: "Operatori ekonomik duhet të paraqesi fletë analizë ose raport testimi për mallrat objekt prokurimi, të lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të lëshuar nga një laborator i çertifikuar nga organet kompetente të Shtetit Shqiptar." pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

- Nuk përmbush pikën 2.3.5 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: “Operatori ekonomik duhet të ketë impiant prodhimi dhe përpunimi të inerteve në pronësi/me qera ose të paraqesë Kontratë Furnizimi për mallrat objekt prokurimi, të lidhur para noterit, me afat deri në përfundimin e kontratës. Për impiantin duhet të paraqitet Leje Mjedisore tipi B (Kodi III.1.B) në përputhje me objektin e prokurimit, të vlefshme deri në realizimin e kontratës.” pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.
- Nuk përmbush pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi analizën e çmimeve për të gjithë zërat objekt prokurimi.” pasi nuk ka paraqitur asnjë dokument për plotësimin e kësaj pike.

4. Operatori Ekonomik “S I R E T A 2F” shpk me NUIS K51501008J.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi fletë analizë ose raport testimi për mallrat objekt prokurimi, të lëshuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të lëshuar nga një laborator i çertifikuar nga organet kompetente të Shtetit Shqiptar.”
- Operatori ekonomik nuk ka paraqitur fletë analizë ose raport testimi për të gjithë mallrat objekt prokurimi pasi mungon fletë analiza ose raporti i testimit për zërin “Çakull”.
- Nuk përmbush pikën 2.3.10 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi analizën e çmimeve për të gjithë zërat objekt prokurimi”.

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “SIRETA 2F” sh.p.k rezulton se ky operator ka paraqitur analizën e çmimeve për të gjithë zërat objekt prokurimi por analizat e çmimeve të materialeve janë hartuar gabim në kundërshtim me K.T.Z në fuqi dhe manualin nr. 1 për prodhimin e materialeve të ndërtimit dhe strukturës së kostos, sipas VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e Manualeve Teknike të Çmimeve të Punimeve të Ndërtimit dhe të Analizave Teknike të tyre”.

Në përlllogaritjen e çmimeve njësi për secilin zë, objekt prokurimi janë konstatuar problematikat si mëposhtë vijon:

- Analiza e çmimit për zërin “Çimento” është llogaritur në njësinë m3 (1540.63 lekë pa tvsh) dhe jo në njësinë ton siç është kërkuar në DST. Së dyti, në formularin e ofertës ekonomike për zërin cemento është vendosur njësia ton dhe çmimi njësi për m3 duke sjellë mospërputhje midis njësisë dhe çmimit të përlllogaritur në analizë.
- Në analizën e çmimit për prodhimin e inerteve si granil I, granil II, rërë, filer, stabilizant, çakull dhe gurë kave nuk është pasqyruar struktura e kostos sipas elementëve teknik përbërës pasi si lëndë bazë për prodhimin e të gjithë artikujve është marrë RËRA, e cila nuk mund të përdoret për prodhimin e granilit (I dhe II), stabilizantit, çakullit dhe gurit kave. Gjithashtu në analizë nuk janë përfshirë shpenzimet për makineritë dhe elementë të tjerë që duhen për prodhimin e të gjithë mallrave, objekt prokurimi.

Për sa më sipër rezulton se analiza e çmimeve, dorëzuar nga OE nuk është e saktë dhe për rrjedhim nuk konsiderohet e vlefshme.

- Nuk përmbush pikën 2.3.11 të kapacitetit teknik ku është parashikuar se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesi dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtës minimumi 14 t	5 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me kapacitet mbajtës 1.5 - 2 t	2 copë	Pronësi ose me qera
Kamion me vinç	1 copë	Pronësi ose me qera

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme). Për mjetet e marra me qira duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e) çertifikatën e për transport mallrash brenda vendit, (e vlefshme).
- b) Për mjetet e marra me qira të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj, i cili duhet të jetë deri në përfundim të objektit.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të dallohet qartë marka dhe targa e mjetit.
- d) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).”

- Për mjetet me targë DR6762D, DR3821D dhe AA516BH është paraqitur kontratë qiraje me Nr.1401 Rep, Nr 1271 Kol, datë 02.04.2020 lidhur para noteres Alma M.Burgaj, ndërmjet qeradhënësit shoqërisë “SARP&LAB” sh.p.k dhe qeramarrësit shoqërisë “Sireta 2F” sh.p.k, me afat 5 vjeçar. Kjo kontratë ka mospërputhje në pasqyrimin e emrit të administratorit të shoqërisë qeramarrëse, i cili në pjesën e parë rezulton Stefan Çaçi dhe në vazhdim Fatime Pali.

Mjeti me targë AA516BH nuk është i përshtatshëm për transport inertesh pasi rezulton të jete furgon, pra karrocerinë e ka të mbyllur, referuar të dhënave në çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor përkatës.

Për mjetin me targë DR6762D operatori nuk ka paraqitur foto të këtij mjeti.

Mjeti me targë DR3821D nuk është i përshtatshëm për transport inertesh pasi rezulton të jete furgon, pra karrocerinë e ka të mbyllur, referuar të dhënave në çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor përkatës.

- Për mjetin me targë TR6537N është paraqitur kontratë qiraje me Nr.3817 Rep, Nr. 2081 Kol, datë 20.04.2021 lidhur para noteres Alma M.Burgaj, ndërmjet qeradhënësit shoqërisë “R.S&M” sh.p.k dhe qeramarrësit shoqërisë “Sireta 2F” sh.p.k. Kjo kontratë ka mospërputhje në datën e lidhjes së kontratës, përkatësisht të vitit pasi në faqen e parë (kapakun e kontratës) është shënuar 20.04.2021 ndërsa në faqen e dytë 20.04.2020 (dymijë e njëzet). Gjithashtu në kontratë mungon nënshkrimi i administratorit të shoqërisë “Sireta 2F” sh.p.k.

Për mjetin me targë TR6537N operatori nuk ka paraqitur çertifikatën e pronësisë së mjetit rrugor (dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit).

Për mjetin me targë TR6537N nuk është paraqitur çertifikatë e rregullt për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit. Në çertifikatën e

paraqitur nga operatori ekonomik lidhur me mjetin, citohet “Per transport mallrash brenda vendit për llogari të vët”, pra të qeradhënësit (“R.S&M” sh.p.k). Sa më sipër, paraqitja e dokumentacionit lidhur me mjetin do të konsiderohet e pasaktë.

Si rrjedhim operatori ekonomik nuk përmbush kriterin për të paraqitur kamion me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin ekonomik “**SHPRESA – AL**” shpk me NUIS K31321021N, dhe adresë: Rruga “Urani Pano”, mbrapa “Veve Center”, Pallati Nr.11, Kati 2, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **39.983.000** (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mije) lekë pa tvsh, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga “5 Maji”, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes/ publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.05.2021

Ankesa: Nuk ka